



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:050477

Datë: 28.03.2019

Numri i dokumentit: 00261034

P.nr.200/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren – dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lënden penale kundër të akuzuarës **Sh. Sh. K.** – nga Suhareka, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale të paraparë me nenin 320 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.910-5/18 të dt. 12.04.2018, në prezencën e PSH Beqë Shala, të akuzuarës, me dt. **28.03.2019**, muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara Sh. Sh. K., e lindur me 17.01.1981 në B., me vendbanim në Suharekë rr. “B. 1..” lok. 12, me profesion frizerk, e ka të kryer shkollimin fillor, shqiptare, shtetase e Republikës të Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Prej datës së pa vërtetuar deri me datë 10.11.2017 e akuzuara me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për veten apo për personin tjetër në lokalitetin e cili gjendet në rrugën B. 1.. lok. 12 në Suharekë, në mënyrë që kapaku i njësorit ishte i hapur pllombat e këputura, teli i mbllobave ishte i këputur dhe i ngjitur me letkon, në mbrendi i njësorit sistemi fazës L1 dhe L3 janë eliminuar ku si pasojë njëtori ka regjistruar për 66.66% me pak të energjisë së shpenzuar, me çka të dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 2743.89 euro.

Këso dore ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale të paraparë me nenin 320 të KP.

Gjykata duke aplikuar nenet 85,86, në lidhje me nenin 320 të KP dhe nenet 498 dhe 499 të KPP, të akuzuarës, i shqipton:

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

E akuzuara Sh. Sh. K. është fajtores për veprën si në aktakuzë, ndaj të njëjtës gjykata i shqipton vërejtje gjyqësore.

Obligohet e akuzuara me shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € dhe në emër të taksës për kompensim të viktimave të krimit shumë prej 30 €, pas plotefuqishmeris se aktgjykimit.

Ar sy et im

PTH në Prizren kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzë PP.II.nr.910-5/18 të dt. 12.04.2018, kundër të akuzuarës Sh. Sh. K. nga Suhareka për shkak të veprës penale vjedhje te shërbimeve komunale te paraparë me nenin 320 të KP, aktakuzen gjatë séances gjyqësore e ka përfaqësuar PSH Beqë Shala, i cili në tërsi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë që e akuzuara të shpallet fajtores dhe të denohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.28.03.2019 dhe në vetë pranimin nga ana e te akuzuarës ka vërtetuar këte gjendje faktike:

Në tërsi është vërtetuar prej datës se pa vërtetuar deri me datë 10.11.2017 e akuzuara me qellim te përfitimit te kundërligjshëm per veten apo per personin tjetër ne lokalin i cili gjendet ne rrugën B. 1.. lok. 12 ne Suhareke, ne menyre qe kapaku i njësorit ishte i hapur pllombat e këputura, teli i mbllobave ishte i këputur dhe i ngjitur me letkon, ne mbrendi i njësorit sistemi fazës L1 dhe L3 jane eliminuar ku si pasoje njëSORI ka regjistrua per 66.66% me pak te energjis se shpenzuar, me qka te dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dem ne vlere prej 2743.89 euro.

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarës e cila në shqyrtimin gjyqësor, në mbrojtjen e saj vullnetarisht e ka panuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarës është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza siq janë: Kallximi penal, si procesverbali – raporti me nr. 085.... të dt. 10.11.2017, proced nr.4./08 i dt. 08.02.2018, raporti i kalkulimit RH me nr.165... të dt. 09.02.2019, fatura DPZHP181.... e dt.09.02.2018, proces per pranimin e instalimit elektrik, si dhe foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera te lendes janë prova te mjaftueshme dhe te besueshme se ne veprimet e te akuzuarës formohen te gjitha elementet e veprës penale e cila i vihet ne barre..

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis ne shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarës është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 paragrafi 4 nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hüdhen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale nga 253 te KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale veprën penale vjedhje te shërbimeve komunale te paraparë me nenin 320 të KP, gjykata ka vendosur të akuzaren ta shpallë fajtores dhe ia shqiptoi denimin siq është cek në aktgjykim.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi denimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 85 dhe 86 të KPP.

Gjykata si rrethanë lehtësuese pati parasysh se e akuzuara ka patur qëndrimin korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërsi të veprës së kryer, është penduar për veprën e kryer, të dëmtuarës në tërsi ia ka kompensuar dëmin , më parë kurr nuk ka rënë ndesh me ligjin ,kurse rrethan posaqerisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP.

Vendimi me të cilin është obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimës së krimit është marrë konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagraf 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË,
P.nr. 200/18 të dt. 28.03.2019**

Sek. Juridike
F. Kabashi

G j y q t a r i
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.